



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BANKËN E SHQIPËRISË

Rekomandimet bazuar në konstatimet e auditimit të ushtruar pranë Bankës së Shqipërisë, me objekt “Për vlerësimin e aktivitetit ekonomik financiar, zbatimi i buxhetit dhe rregullshmëria e zhvillimit të ankandeve të bonove të thesarit dhe të obligacioneve” për periudhën 01.01.2013 – 31.12.2013, janë miratuar me Vendim Nr. 108, datë 09.09.2014 të Kryetarit të KLSH-së. Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me shkresën nr. 188/8, datë 15.09.2014, i janë përcjellë subjektit, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse.

Në përgatitjen e rekomandimeve pas këtij misioni auditimi kemi qënë të vëmendshëm për të mosçenuar pavarësinë organizative dhe operuese të Bankës së Shqipërisë në përm bushjen e misionit të saj kushtetues, duke inkurajuar konsolidimin e arritjeve në fushën e politikës monetare, krahas shikimit me një sy kritik të mangësive në mbikëqyrjen dhe administrimin e fondeve në dispozicion.

Nga, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Ligji nr. 8269 datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” shikohet si një ligj i cili, siguron pavarësi institucionale dhe hapësirë të mjaftueshme për të realizuar objektivin kryesor të saj. Duke patur parasysh zhvillimet dinamike në tregun bankar europian, pasurimin e vazhdueshëm të përvojave dhe kërkesave të kohës për një rol më aktiv të bankave qendrore në dhënien e impulseve pozitive në ekonominë e vendeve, kemi theksuar nevojën për përmirësime ligjore, për të cilat vetë Banka duhet të kishte ndërmarrë iniciativa ligjore. Kemi nënvizuar gjithashtu se përmirësimet ligjore të synuara duhet të zhvillohen në konsultim të ngushtë me institucionet e rëndësishme financiare ndërkombëtare si Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore si edhe Bankës Qendrore Europiane.

Në vijim po japim aspekte që kanë nevojë për ndërhyrje si ligjore ashtu edhe organizative, bazuar në konstatimet e këtij auditimi, në vlerësime të analizës së problematikave si dhe kohëzgjatjeve të tyre si dhe të gjykimëve të pavaruara për ndërhyrje të cilat në gjykimin tonë do të përmirësonin mirëadministrimin, transparencën dhe llogaridhënien në funksion të ritjes së besimit ndaj këtij Institucioni të rëndësishëm.

Nisur nga funksionet që Ligji nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i ka atribuar Këshillit Mbikëqyrës në politikëbërje, mbikëqyrje dhe administrimin e këtij institucioni por dhe raporteve të përfaqësimit të administrimit në Këshill sipas përcaktimeve në këtë ligj, duke vlerësuar sitë rrezikuar vendimmarrjen sidomos në rastet kur

Inspektori i Përgjithshëm vlerëson negativisht performancën e Bankës, tërësore ose pjesore, atëherë ka mundësi në masë të konsiderueshme që të mos realizohet kourumi i nevojshëm brenda këtij Këshilli për përmirësime të situatës. Në këtë kontekst kemi rekomanduar:

- Përfaqësimi i administrimit në Këshillin Mbikëqyrës të bëhet vetëm nga Guvernatori, pasi gjykojmë se një përfaqësim i tillë do t'i jepte hapësirën e nevojshme Këshillit Mbikëqyrës për të kryer saktësisht funksionet mbikëqyrëse që atij i atribuohen me ligj dhe shmang pozitën "dominuese" të administrimit në Këshillin Mbikëqyrës (3 anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës janë ligjërisht në nivelin më të lartë të administrimit). Eksperienca e bankave qendrore të vendeve të zhvilluara ka dëshmuar se prania vetëm e Guvernatorit në nivele të tilla vendimmarrëse është mëse e mjaftueshme dhe ndarja e funksioneve të administrimit nga politikëbërja dhe mbikëqyrja sjellin efekte pozitive në nivelin e transparencës dhe llogaridhënies në mënyrën e administrimit të fondeve në dispozicion. Gjithashtu kërkojmë të saktësohen më mirë detyrat funksionale të Këshillit Mbikëqyrës dhe administratorëve të Bankës me synimin për të shmangur dualizmin e funksioneve, konfliktin e kompetencave dhe për të siguruar një nivel të dëshirueshëm llogaridhënie, transparence dhe mbikëqyrjeje.

Në përgjigjen për qëndrimin e saj ndaj Raportit Përfundimtar të Auditimit, Banka nuk shprehet për këtë rekomandim.

Nisur nga fakti se Këshilli i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë është një bord specifik me detyra të rëndësishme dhe komplekse të lidhura me drejtimin dhe monitorimin e një tregu të rëndësishëm si ai monetar, me reflektime të qarta dhe të mprehta në gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë, faktit që bazuar në rregullat e brendshme të Bankës, konfliktit të interesit për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund ti jepet një kuptim më i gjerë së nenet 30 dhe 31 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", si dhe rasteve kur anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës mediatizohen me qëndrime personale mbi politikën monetare, përdorin figurën e tyre për komercializëm të pastër tregtar apo kanë pjesëmarrje të tepruar në borde dhe këshilla mbikëqyrës ku administrohen fonde publike dhe private kemi rekomanduar që të ketë kritere specifike dhe kushtëzime për anëtarët e këtij këshilli duke sugjeruar:

- Vendosjen e kufizimit të plotë të pjesëmarrjes së tyre në këshilla dhe borde të tjerë përveç atyre të fushës akademike dhe shkencore.

- Të kërkohej mospërdorimi i figurës në aktivitete apo promovime që cenojnë integritetin e figurës së anëtarit të një bordi kaq të rëndësishëm.

- Kufizimi i daljeve publike dhe mbajtjes së qëndrimeve individuale mbi aspekte të politikës monetare në një kohë që paraqitet një qëndrim i Këshillit Mbikëqyrës në deklaratën për shtyp të Guvernatorit, pasi kjo mund të nxisë refleksione dhe reagime jokorrekte të operatorëve në treg.

- Ndërkohë, duke vlerësuar maksimalisht kontributin e tyre në jetën publike dhe ekonomike të vendit, dhe vetë sfidat që ka përpara ky Institucion i rëndësishëm së veçantë, për tu përballuar me realitete të mbartura nga e kaluara, i kërkojmë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të japin dorëheqje nga bordet dhe pjesëmarrjet e tjera publike dhe politike dhe aq më tepër përdorimit

të figurës së tyre, në dobi të bizneseve private, përfshirë dhe ato të reklamimit të sistemit universitar privat në vend.

Në përgjigjen e saj Banka thekson se këto rekomandime nuk pranohen ato mund ti drejtohen Kuvendit por sipas gjyqimit të tyre çështjet mbeten në vlerësim të Guvernatorit dhe anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës.

Ligji nr.8269, datë 23.12.1997 i ndryshuar “Për Bankën e Shqipërisë” në nenin 73 të thekson se Banka e Shqipërisë përjashtohet nga të gjitha tatimet dhe taksat. Si pasojë e këtij përcaktimi, Banka e konsideron veten në pozicion të vështirë për të plotësuar të gjitha detyrimet fiskale si rrjedhojë e marrëdhënieve kontraktuale në të cilat ajo përfshihet për të realizuar aktivitetin operativ të saj. Kështu, lidhur me këtë çështje gjatë auditimit kemi konstatuar se:

a. Për dy kontratat me arkitektin M.P, me seli në Itali, (kontratës me nr. 9781, date 23.11.2011 në vlerën prej 700,000 euro për hartimin e projektit të rikonstruksionit të godinës qendrore, e cila deri në fund të vitit 2013 është likuiduar në masën 50 %, kontratës me nr.1164, datë 24.07.2013 në vlerën prej 32,100 euro për hartimin e projektit të zhvillimit të ambientit dhe trotuanit përreth ndërtesës së Bankës së Shqipërisë) nuk janë respektuar kërkesat e ligjit nr.7928, date 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” i ndryshuar (neni 15), ku cilësohet se, në rast se furnizimi i shërbimit ka të bëjë me pasuri të paluajtshme, atëherë vendi i furnizimit është vendi ku ndodhet pasuria e paluajtshme. Banka nuk i ka kërkuar personit të kontraktuar të regjistrohet në Shqipëri por nga ana tjetër me pretendimin se është e përjashtuar nga të gjitha tatimet dhe taksat nuk ka zbatuar kërkesat e Ligjit nr.7928, date 27.04.1995 për ta deklaruar këtë shërbim si pjesë të aktivitetit të saj, meqenëse marrëdhënia kontraktuale është me një jorezident. Kjo ka sjellë një mungesë në skemën e TVSH prej 17,1 milionë lekë.

b. Lidhur me administrimin e Fondit të Pensioneve u konstatua se të ardhurat e realizuara nga investimi i këtij fondi vetëm për vitin 2013, arritën në vlerën 104 milionë lekë. Ligji Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të ardhurat”, në nenin 4, shpjegon se të ardhurat nga një burim në Republikën e Shqipërisë, pa u kufizuar vetëm në to, do të përfshijnë të ardhurat, pika g) të ardhurat nga interesat e paguar nga organet e qeverisjes qendrore apo vendore ose nga një rezident i Republikës së Shqipërisë, ose që paguhet nga një jo rezident, nëpërmjet një personi që ka seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë.

c. Gjithashtu kemi konstatuar se në fitimin e vitit 2012 është zbritur vlera 8 milionë lekë, për sistemime të llogarive të kaluara të lidhura me taksat e paguara në doganë për pajisjet e importuara për nevoja të aktivitetit të Bankës. Pra Banka ka provigjionuar këtë shumë duke i konsideruar si humbje detyrimet e paguara për mjetet e saj ndërkohë që gjykojmë se pagesat e detyrimeve tatimore dhe doganore (TVSH) për sa kohë që aktiviteti i saj është i përjashtuar përbën kosto të shërbimit apo aktiveve që ajo ka përfituar. Sa cilësuar më sipër kemi rekomanduar:

- Kuvend të bëjë plotësimin e nenit 73 të Ligjit nr.8269 datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” i ndryshuar, në mënyrë që të saktësojë pozicionin e Bankës përballë kërkesave të

ligjeve në fushën e tatimeve dhe doganave, për të eliminuar keqinterpretimet që kanë sjellë praktikat e deritanishme.

Në përgjigjen e saj Banka thekson se këto rekomandime nuk pranohen ato mund ti drejtohen Kuvendit të Shqipërisë.

Fondi i Pensioneve është krijuar në përputhje me nenin 4 shkronja (a) të Ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 i ndryshuar “Për Bankën e Shqipërisë” dhe rregullimi i tij bëhet me Vendim të Këshillit Mbikëqyrësasi Ligji nr.10197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar” në nenin 110 ka përjashtuar nga zbatimin i dispozitave të këtij ligji fondin e pensionit të krijuar sipas ligjit për Bankën e Shqipërisë, për këtë kemi rekomanduar.

- Kuvendi të amendojë nenin 110 të Ligji nr.10197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar”, në mënyrë që edhe për këtë fond të zbatohen dispozitat ligjore të këtij ligji ose Kuvendi të iniciojë hartimin e një dispozite të plotë ligjore për të rregulluar politikat e administrimit, procedurat për miratimin e politikës së investimit të fondit privat të pensionit si dhe vendosjen e një kufiri maksimal page mbi të cilën të llogariten kontributet që Banka duhet të paguajë për këtë fond.

Në përgjigjen e saj Banka thekson se ky rekomandim nuk pranohet dhe sipas saj Rregulloja e Fondit të Pensionit të Bankës së Shqipërisë dhe Ligji për Pensionet Vullnetare janë në të njëjtën linjë përcaktimesh ligjore dhe rregullative dhe nuk ka asnjë vakum ligjor, përkundrazi është në harmoni jo vetëm ndërmejt tyre por edhe me legjislacionin e skemave të pensioneve vullnetare, të cilat udhëhiqen nga parimi i përgjithshëm i lehtësimit të barrës fiskale në forma të ndryshme.

Banka e Shqipërisë nëpërmjet politikës monetare lehtësuese të ndjekur edhe për vitin 2013, duke reduktuar normën bazë të intesetit me 1 pikë përqindje në krahasim me vitin 2012, nëpërmjet katër vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës për uljen e saj me nga 0.25 pikë përqindje, respektivisht në muajt janar, korrik, nëntor dhe dhjetor të këtij viti, ka synuar uljen e kostos së kreditimit të sektorit privat për të stimuluar rritjen ekonomike. Kemi konstatuar se kjo politikë është shoqëruar me rënien e ndjeshme të normave të interesit për depozitat e kursimit dhe uljen e kostos së bankave. Nga ana tjetër, konstatimet mbi gjëndjen aktuale të tregut, trendin e kanalizimit të fondeve dhe ndikimi në kreditim, kanë treguar se tregu financiar shqiptar ka patur një ndjeshmëri të ulët ndaj normave të interesit. Duke dashur të jemi të kujdesshëm dhe të mos ndërhyjmë dhe cënojmë sado pak pavarësinë e saj në zbatimin e politikës monetare sugjerojmë që Banka të vlerësojë me kujdes instrumentet që do të përdorë në të ardhmen për plotësimin me efektivitet të objektivave kryesorë të saj.

Nga ana e Bankës ky rekomandim quhet i papranueshëm për faktin se e drejta dhe detyrimi i Bankës së Shqipërisë për zbatimin në mënyrë të pavaruar të politikës monetare është një e drejtë e njohur në Kushtetutë, për çështje të politikës monetare ajo nuk mund të kërkojë apo pranojë këshilla, sygjerime apo rekomandime nga asnjë institucion publik apo privat, përfshi këtu edhe KLSH. Gjithsesi sipas saj shkalla e suksesit të realizimit të objektivave të politikës monetare, instrumentet e përdorur dhe efektiviteti i tyre nuk mund të jenë subjekt kontrolli apo vlerësimi të KLSH. Pranimi i këtij sygjerimi do të përbënte de-facto shkelje të pavarësisë.

Lidhur me këtë rekomandim theksojmë se Institucionet Supreme të Auditimit nuk mund të gjykojnë dhe auditojnë politikat por efektivitetin dhe rezultatet e politikave janë funksionet e tyre kryesore në ditët e sotme. Vlerësimi i performacës është misioni që kërkohet të përbushet nga një institucion i standardeve europiane dhe drejt të cilit ne po mundohemi të zhvendosemi me shpejtësi. Gjithsesi duke vlerësuar maksimalisht kapacitetet profesionale të Bankës së Shqipërisë në këtë fushë rekomandimet tona kanë qënë të kujdesshme dhe modeste.

Nga auditimi i rregullshmërisë së zhvillimit të ankandeve të bonove të thesarit dhe obligacioneve të organizuara nga Banka e Shqipërisë, në zbatim të marrëveshjeve të lidhura midis Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë kemi konstatuar se Banka e Shqipërisë është pjesëmarrëse në ankandet që zhvillohen për bono thesari, me të drejtën e rezervimit të shumës së kërkuar prej saj, pavarësisht nëse kërkesat jokonkurrense nga ana e individëve mund të jenë të larta. Nga auditimi u konstatua që pjesëmarrja e individëve në ankandet e bonove të thesarit ka pësuar ulje gjatë vitit 2013, nga 59,374 milion lekë ose 23% të totalit të vlerës së emetuar në fillim të vitit, në 55,551 milion ose 22% të totalit në fund të vitit 2013. Po kështu, niveli i pjesëmarrjes së individëve nëpërmjet kërkesave jokonkurrense në ankandet e obligacioneve është mjaft i ulët, vetëm 1 % të shumës totale të emetuar gjatë vitit 2013. Për sa më sipër kemi rekomanduar që Banka e Shqipërisë, në rolin e saj këshillimor për qeverinë, të ndikojë në marrjen në konsideratë të mekanizmave më të efektshëm, më qëllim që jo vetëm të mos ulët por të nxitet pjesëmarrja më e gjerë e individëve në tregun e instrumentave të emetuar nga qeveria, gjithashtu të ndikojë për rritjen e shkallës së informimit të publikut mbi këtë treg.

Ky rekomandim nga ana e Bankës quhet i papranueshëm, pasi sipas saj marketingu për një letër borxhi bëhet vetëm nga emetuesi. Instrumentet e politikës monetare kanë si objektiv të drejtëpërdrejtë dhe të vetëm zbatimin e politikës monetare.

Theksojmë se rekomandimi nuk i kërkon Bankës të bëjë marketingun e letrave të qeverisë por i kemi kërkuar të këshillojë qeverinë për një marketing më të mirë të instrumentave afatshkurtër, apo mekanizmave që do të sillnin që niveli i pjesëmarrjes së individëve në këto instrumenta të rritet.

Gjatë vitit 2013, nuk ka patur kredihënje të drejtëpërdrejtë nga Banka. Kemi konstatuar se portofoli i bonove të thesarit të financuara nga Banka e Shqipërisë është 63,920 milion lekë. Konstatohet pjesëmarrje e Bankës së Shqipërisë në ankandet e bonove të thesarit 3, 6 dhe 12 mujore por edhe në obligacione kryesisht me fondin e pensioneve të punonjësve. Banka ka injektuar në vazhdimësi likuiditet në sistemin bankar, nëpërmjet marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes me afat të shkurtër (një javore ose një mujore). Financimi nëpërmjet marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes për sistemin bankar në fund të vitit 2013 ishte 21.5 miliardë lekë, nga 21.8 miliardë lekë në fund të vitit 2012.

- Për këtë kemi rekomanduar që të saktësohet dhe plotësohet baza rregulative lidhur me dispozitat e nenit 30 të Ligjit nr. 8269 datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të ndiqet një politikë e kujdesshme dhe veprime efektive që do të mundësonin kontrollin e niveleve të kreditimit për qeverinë si dhe rritjen e efektivitetit në transmetimin në treg të politikës monetare.

Nga auditimi i procedurave të ankandëve janë konstatuar raste të paraqitjes së dy kërkesave konkurruese, me shuma të ndryshme, por me të njëjtin yield, nga i njëjti subjekt, të cilat janë marrë parasysh të dyja nga Komisioni i Ankandit. U konstatua se nga 36 ankande të zhvilluara për emetimin e obligacioneve, në 11 prej tyre nuk janë plotësuar objektivat dhe kemi patur rihapje në një kohë të dytë, 10 deri në 30 ditë pas datës së zhvillimit të tyre. Marrëveshja midis Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë e paraqet rihapjen e ankandëve, kur nuk arrihen objektivat, por nuk shprehet për afatin kohor përkatës. Rihapja e ankandëve është njoftuar vetëm nëpërmjet sistemit Reuters dhe nuk parashikohet në kalendarin që dërgohet nga Ministria e Financave për programin kohor të emetimit. Për këtë kemi rekomanduar:

- Të shqyrtohet mundësia për të bërë plotësimet e nevojshme në kuadrin rregulator mbi bazën e të cilit kryhet organizimi i ankandëve dhe që do të ndikonin në një politikë më të kujdeshme nga ana e qeverisë lidhur me manaxhimin e Cash-it, kjo duke shfrytëzuar edhe rolin e Bankës si këshilluese për Qeverinë.

Edhe ky rekomandim nuk është pranuar nga ana e Bankës, sipas gjykimit të saj është njësi përgjegjëse për administrimin dhe organizimin e ankandëve publike përgjegjëse për zbatimin dhe pasurimin e rregulloreve.

Nga kontrolli i ushtruar rezulton se fazat e hartimit të projektbuxhetit janë ndjekur me përpikmëri por për shkak të konstatimit se niveli i realizimit të investimeve ka vetëm trend rënës dhe për vitin 2013 ato u realizuan vetëm 32% (plan/fakt) gjykojmë se procesi ka element formaliteti. Planifikimi bazohet kryesisht mbi të dhëna historike dhe nuk merr në konsideratë elementë të tilla si ekzistenca e problemeve teknike me të cilat është hasur rikonstruksioni i ndërtesës së ish "Hotel Dajtit", vonesa në realizimin e punimeve të programuara për Godinën Qendrore të Bankës, shtesa në projektet fillestare të cilat kërkojnë edhe procedura shtesë por edhe shkaktojnë vonesa në punimet e planifikuara (Rasti i Muzeut të Bankës), varësia e realizimit të investimit nga një investim tjetër (efekti zinxhir). Për këtë kemi rekomanduar:

- Nga ana e Departamentit të Kontabilitetit, Financës dhe Pagesave të bëhen përpjekje për një planifikim sa më real të investimeve. Në planifikim duhet të merren parasysh kostot oportune për çdo shtyrje apo mos realizim investimesh për të rritur ndjeshmërinë e personelit që ndjek realizimin e këtyre investimeve për efektet negative që kanë shkak vonesat në realizimin e kontratave.

Në përgjigjen e Bankës rekomandimi është vlerësuar dhe është marrë në konsideratë për t'u zbatuar në vazhdimësi.

Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" në nenin 45, përcakton të drejtën që Këshilli Mbikëqyrës të përcaktojë shpërblimin e tij. Shpërblimi i anëtarëve dhe kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës bëhet në bazë të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës Nr. 27, datë 26.03.2008, ndryshuar me Vendimin Nr.13, datë 13.02.2013, që përcakton shpërblimin mujor të anëtarëve. U konstatua se për dy prej anëtarëve të këtij këshilli në mbarim të mandatit në muajin dhjetor të vitit 2013, janë bërë pagesa në vlerën 3,992,694 lekë si shpërblim në masën 150 % të shpërblimit mujor për çdo vit qëndrimi në detyrë. Pagesë e bazuar në Vendimin e

Këshillit Mbikëqyrës nr. 32, datë 27.04.2011 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 27, datë 26.03.2008 “Për shpërblimin e anëtarëve dhe të Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë”, pika 3/1, germa a ku theksohet shprehimisht se “Në mbarim të afatit të qëndrimit në detyrë, ose largimit nga detyra për raste të ndryshme nga ato të përcaktuara në nenin 47, pika 2 e ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, anëtarët dhe kryetari i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë përfitojnë; (a) Një shpërblim në masën 150% të shpërblimit mujor, për çdo vit të qëndrimit në detyrë. Periudha e qëndrimit do të llogaritet nga data e emërimit në detyrën e Anëtarit ose të Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, deri në datën e largimit nga detyra”.... Bazuar në këtë konstatim kemi rekomanduar që:

Të shfuqizohet Vendimi nr. 32, datë 27.04.2011, i Këshillit Mbikëqyrës si dhe të përcaktohen dhe kontabilizohen detyrimet financiare të lindura për shkak të këtij anulimi.

Në përgjigjen e Bankës rekomandimi quhet i zbatuar, në shkresë cilësohet fakti se Këshilli Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 01.10.2014 vendosi në parim të revokojë vendimin nr. 32 datë 27.04.2011 “Për disa ndryshime në vendimin e KM nr. 32, datë 23.06.2008 “Për shpërblimin e anëtarëve dhe të kryetarit të KM në Bankën e Shqipërisë.

- Të bëhen plotësime dhe saktësime në nenin 45 të Ligjit organik të Bankës, pasi mungesa e përcaktimit të saktë të llojit dhe masës së shpërblimit për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës në ligj, ka krijuar hapësirën për një vendim të tillë, të cilin e gjykojmë se ka tejkaluar kufijtë e të drejtës që ligji përcakton në nenin 45. Kërkuam të saktësohet në ligj lloji, masa dhe numrin total i shpërblimeve që mund të përfitohen nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës.

Banka në përgjigjen e saj nuk pranon rekomandimin, pasi sipas tyre rekomandimi del jashtë objektit të veprimtarisë së KLSH, por gjykohet edhe i pabazuar pasi në bazë të dispozitave në fuqi këto janë kompetenca të Këshillit Mbikëqyrës. Cdo ndryshim i tyre realizohet nga Kuvendi i Shqipërisë.

- Ndërkohë, i kemi rekomanduar edhe Bankës së Shqipërisë, plotësimin e mëtejshëm të dispozitave ligjore për vendosjen e rregullave të çarta lidhur me llojin, masën dhe kohën e shpërblimeve të Këshillit Mbikëqyrës. Çdo vendimmarrje në të ardhmen të realizohet duke marrë në konsideratë shmangien e konfliktit të interesit ndërmjet vendimmarrësve dhe përfituesve të këtyre shpërblimeve duke synuar kështu kombinimin më të mirë të pavarësisë institucionale dhe financiare që ligji i ka atribuar Bankës dhe mirëmbajtjes së kësaj pavarësie. Në lidhje me këtë rekomandim Banka nuk shprehhet.

Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” përcakton se Banka e Shqipërisë është e pavarur në përcaktimin e shpërblimeve të stafit të saj, pavarësi që sipas nenit 45 i njeh të drejtën Këshillit Mbikëqyrës që të vendosi për llojin, nivelin e pagave dhe shpërblimeve. U konstatua rregullshmëri në fushën e përcaktimit të pagave dhe shpërblimeve bazuar në vendimmarrjen e Këshillit Mbikëqyrës. Shpenzimet e personelit kanë patur një rritje të lehtë për vitin 2013 dhe kjo tregon një trend të konsoliduar rritës të këtij zëri që zë 35% të totalit të shpenzimeve të Bankës. Gjatë vitit 2013 kostoja e këtij zëri është rritur me 26 milionë lekë krahasuar me vitin 2012. Nga Banka mbrohet me fanatizëm fakti që pagat janë të larta për të mundësuar mbajtjen e stafit të kualifikuar por pamundësia për të patur akses në të dhënat mbi

kapacitet profesionale të këtij stafi (dosjet e personelit nuk na u vunë në dispozicion nga ana e bankës nën arsyetimin e konfidencialitetit) nuk na lejon të gjykojmë mbi këtë pretendim të ngritur nga Banka. Gjithashtu në referencë të faktit se rekomandimi i lënë nga auditimi “Për vlerësimin e aktivitetit ekonomik financiar, zbatimi i buxhetit dhe rregullshmëria e zhvillimit të ankanëve të bonove të thesarit dhe të obligacioneve” për vitin 2012, nuk është marrë në konsideratë si dhe duke vlerësuar rëndësinë që paraqet zbatimi i rekomandimeve tona mbi disa ndryshime dhe përmirësime ligjore në ligjin organik të Bankës së Shqipërisë, sidomos në rritjen e nivelit të përgjegjshmërisë lidhur me kompetencën në përcaktimin e pagave dhe shpërblimeve keqadministrimi i të cilës mund të ndikojë negativisht në imazhin që opinion i gjerë publik ka ndaj këtij Institucioni të rëndësishëm, përsërisim rekomandimin e dhënë në auditimin e vitit 2013, duke theksuar disa aspekte të lidhura me elementë të transparencës. Kështu kemi kërkuar:

- Rishikimin e ligjit, në frymën e minimizimit të riskut potencial të abuzimit me pavarësinë dhe shmangies së konfliktit të interesit që evidentohet në praktikën e përcaktimit të pagave dhe shpërblimeve për nivelet drejtuese.

- Përcaktimi i një kornize të kujdesshme rregullatore në lidhje me nivelin e pagës së Guvernatorit, e cila duhet të ndjekë trendin e pagave të tregut bankar, por gjithmonë duhet të jetë në raporte të pranueshme krahasuar me pagën e Presidentit të Republikës, bazuar kjo jo vetëm në përvojat dhe praktikën më të mira të vendeve të ngjashme, por edhe në përshtatshmërinë me realitetin shqiptar (rekomandim i përsëritur).

- Kërkesën për një transparencë të detyrueshme ligjore për çdo vendim të lidhur me pagat dhe shpërblimet e stafit dhe jo vetëm, çka presupozon informimin e vazhdueshëm të opinionit të gjerë publik në lidhje me çdo përfitim financiar dhe monetar.

Banka në përgjigjen e saj nuk pranon rekomandimin, pasi sipas tyre rekomandimi del jashtë objektit të veprimtarisë së KLSH, por gjykohet edhe i pabazuar pasi në bazë të dispozitave në fuqi këto janë kompetenca të Këshillit Mbikqyrës. Cdo ndryshim i tyre realizohet nga Kuvendi i Shqipërisë.

- Të gjitha shtesat që përfitohen në formë monetare të përfshihen në llogaritjen e pagës së punonjësit sipas kërkesave të ligjit mbi të ardhurat. Të derdhen në buxhet diferencat e rezultuara gjatë këtij auditimi. Banka në përgjigjen e saj ka pranuar rekomandimin.

Auditimi konstatoi se pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me politikat kontabël të përshtatura në Manualin e Kontabilitetit të Bankës, miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendimin Nr. 50, datë 26 janar 2001 por dhe politika të tjera të miratuara nga Këshilli Mbikqyrës i Bankës duke tentuar një pajtueshmëri të përgjithshme me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të aprovuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Pavarësisht këtij përafrimi të synuar, theksojmë se baza e pasqyrave janë ato të Manualit të Kontabilitetit të vetë Bankës. Bazuar në këtë konstatim por edhe në funksion të rritjes së cilësisë së informacionit të publikueshëm nga ana e Bankës për të gjithë përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm kemi rekomanduar që:

- Banka të kalojë në përgatitjen e pasqyrave në përputhje të plotë me standardet e raportimit financiar (SNRF), të bëjë rishikimin e Manualit të Kontabilitetit të Bankës në të cilin të jenë

të shpjeguara gjerësisht deviacionet që mund të ketë implementimi i plotë i SNRF në kushtet reale të vendit dhe duke i eliminuar Këshillit të Mbikëqyrjes përgjegjësinë për elementë plotësisht të natyrës kontabël.

- Në funksion të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies të jepet një nivel i tillë shënimesh shpjeguese që lejon lexuesin të krijojë binde objektive për politikën kontabël të përdorur për zëra të veçantë dhe impaktin e kësaj politike kontabël në pasqyrat e paraqitura nga Banka.

- Banka të stimulojë me një politikë të kujdesshme ngritjen e kapaciteteve njerëzore të përfshira në këtë proces sa kompleks dhe të rëndësishëm për rritjen e besueshmërisë së informacionit për pozicionin financiar të bankës.

Banka në përgjigjen e saj shpreh dakordësinë për këtë rekomandim dhe thekson se po merren masa për zbatimin e tij.

Nga auditimi i punës së Departamentit të Kontrollit rezultoi se kjo strukturë është e konsoliduar nga pikëpamja e kapaciteteve të burimeve njerëzore në dispozicion, pavarësisht pavarësisë së kufizuar që konstatohet në drejtim të rekrutimit dhe shpërblimit të tyre. Metodologjitë mbi të cilat rregullohet aktiviteti i auditimit janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe kontrollit. Nga shqyrtimi i raportit vjetor të këtij departamenti, u konstatua se në 13 funksione të audituara nga audituesit e brendshëm vetëm në dy prej tyre, vlerësimi mbi mënyrën e funksionimit është i pranueshëm ndërsa për 11 funksionet e tjera ata cilësojnë nevojën për përmirësim dhe janë dhënë 107 rekomandime në drejtim të përmirësimit të sistemeve dhe rritjes së efikasitetit të burimeve nga të cilat rezultoi se janë zbatuar vetëm 21 rekomandime ose 19% e tyre. Pjesa tjetër cilësohet si rekomandime në proces. Theksohet fakti se janë konstatuar rekomandime nga viti 2006 të pa zbatuar duke i bërë sistemet e kontrollit jo efektive.

Nisur nga raportet e auditimit të përgatitura nga audituesit e brendshëm, raporti vjetor i aktivitetit të këtij funksioni për vitin 2013, intervistimi i inspektorit të përgjithshëm si dhe pyetësori i plotësuar mbi aktivitetin e auditit të brendshëm në Bankën e Shqipërisë arritën në konkluzionin se pavarësia e funksionimit të auditimit të brendshëm të Bankës së Shqipërisë, nuk mund të inkurajohet nga ana e administratorëve nëse ata përcaktojnë strukturën dhe buxhetin e këtij funksioni. Gjithashtu e kemi konsideruar si çenim të pavarësisë mënyrën e planifikimit të misioneve të auditimit por dhe moszbatueshmërinë e rekomandimeve të lëna nga këto misione audituese.

- Bazuar në gjetjet e këtij auditimi, në funksion të rritjes së pavarësisë, efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së strukturës së auditimit kemi rekomanduar që të bëhen përmirësime ligjore duke transformuar funksionin e Inspektorit të Përgjithshëm në një Komitet Auditimi të përbërë nga tre anëtarë, të zgjedhur nga Kuvendi.

- Ndërkohë Bankës i kemi kërkuar të rishikohet baza e brendshme rregullative lidhur me këtë funksion kryesisht lidhur me forcimin e pavarësisë së kësaj njësie në planifikim dhe në mënyrën e raportimit. Të shikohet mundësia e ndryshimit të mënyrës së rekrutimit dhe shpërblimit të stafit në përbërje të Drejtorisë së Kontrollit të Bankës së Shqipërisë, të punohet për ngritje të mëtejshme të kapaciteteve brenda tij. Kemi cilësuar nevojën për përmirësim në drejtim të monitorimit të kuadrit të centralizuar të riskut si edhe në aspektet e vlerësimit të

brendshëm të cilësisë së punës së audituesve dhe funksionit në përgjithësi. Vendosja e mekanizmave që do të përshpejtojnë zbatimin e rekomandimeve të lëna nga departamenti i kontrollit.

Në përgjigjen e Bankës ngrihet pretendimi se rekomandimi për Departamentin e Kontrollit, nuk ka qenë pjesë e Projektraportit të Auditimit, dhe më pas kalohet në komente të cilat në shumicën e rasteve janë të pasakta. Duke patur parasysh që këto komente zënë një pjesë të konsiderueshme të përgjigjes së Bankës por dhe për faktin se venë në dyshim profesionalizmin dhe konsistencën e qëndrimeve tona jemi të detyruar të ndalojmë më gjerësisht.

Shpjegojmë që vlerësimi i sistemeve të kontrollit është pikë e vecantë e programit të auditimit c'ka nënkupton se auditimi ka patur në fokus edhe funksionin e Departamentit të Kontrollit. Konstatimi (përmbledhja) për këtë pikë të programit është në faqen 12 të Projekt Raportit të Auditimit të dërguar me shkresën 188/4 datë 30.06.2014. Rekomandimi i lënë për Bankën në drejtim të forcimit të pavarësisë së këtij funksioni sidomos në planifikim dhe raportim mban nr.30 dhe është lehtësisht i verifikueshëm në faqen 158 të Projekt Raportit të Auditimit.

Ndërkohë në shkresën 405/4 të datës 01.08.2014 të Bankës së Shqipërisë, nuk pati asnjë observacion për sa kishim konstatuar apo vlerësuar në lidhje me këtë funksion. Gjithashtu edhe në ballafaqimin e bërë me grupin e auditimit në fazën përmbyllëse të Raportit të Auditimit, pranë zyrave të KLSH në datën 29.08.2014, nuk pati prezencë të ndonjë përfaqësuesi të Drejtorisë së Kontrollit të Brendshëm apo Inspektorit të Përgjithshëm ku të ngrihej ndonjë pretendim për pasaktësi të konstatimeve tona dhe aq më pak për vlerësime të pa bazuara.

Të dhënat e paraqitura si në Projekt Raport ashtu edhe në Raportin Përfundimtar të Auditimit janë rigorozisht pa ndryshime, ndërkohë që saktësojmë se niveli i rekomandimeve të pazbatuara bazuar në të dhënat që kemi në dispozicion është 18,6% nga 15,8% që jemi shprehur në Raportin e Auditimit. Gjithsesi pavarësisht nga llogaritjet 16%, 19% apo 21% (i deklaruar nga vetë Banka) niveli i zbatimit të rekomandimeve është i ulët.

Na duhet të theksojmë se rekomandimet për forcimin e pavarësisë së këtij funksioni si për ndryshimet ligjore ashtu dhe ato organizative nuk i adresohen Departamentit të Kontrollit kështu që pjesa më e madhe e komenteve vjen se nuk është kuptuar adresimi i rekomandimeve.

Gjithashtu vlerësime apo theksime të rekomandimeve të cilat i referohen analizës që ne i bëjmë situatës në funksion të përsosjes, përmirësime të funksioneve aty ku gjykojmë se duhet janë në të drejtën tonë legjitime në arritjen e objektivit kryesor si mbrojtës të interesave publike. Rekomandimet ligjore në këtë rast i kemi adresuar edhe Bankës së Shqipërisë pasi kemi gjykuar se realizimi i ndërhyrjeve nga vetë Banka do të sigurojë një ndërhyrje të kujdesshme pa çenuar pavarësinë e saj.

Bazuar në konstatimin e bërë në auditimin e vitit 2013, lidhur me përzgjedhjen e audituesit të jashtëm të pasqyrave financiare, për të shmangur konfliktin e interesit të verifikuar në përzgjedhjen e këtij audituesi, sipas nenit 68, të Ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” ku cilësohet se “Llogaritë dhe regjistrat e Bankës së Shqipërisë mund të

kontrollohen nga kontrollorë të jashtëm të institucioneve kontrolluese të njohura në arenën ndërkombëtare dhe që caktohen nga Këshilli Mbikëqyrës”(ndërkohë që Këshilli Mbikëqyrës nuk është i ndarë nga ekzekutivi për shkak të drejtimit të tij nga Guvernatori), dhe fakti që ky rekomandim nuk ka gjetur zbatim kemi rikërkuar

- Të bëhet ndryshimi i mënyrës së përzgjedhjes së audituesit të pasqyrave financiare duke ia kaluar këtë kompetencë Kuvendit të Shqipërisë, referuar edhe praktikave më të mira botërore.

Në përgjigjen e Bankës shprehet qëndrimi kundër këtij rekomandimi duke theksuar se bazuar në rekomandimin e lënë nga Misioni i Fondit Monetar Ndërkombëtar në qershor 2014, përzgjedhja duhet të bëhet bazuar në një procedurë të vecantë përzgjedhje e ndarë nga mënyrat e përzgjedhjes bazuar në rregulloret e prokurimit dhe përzgjedhja të synonte cilësinë e shërbimit dhe jo koston më të ulët. Sipas rregullave të reja të përzgjedhjes të miratuara nga Vendimi nr.36 datë 25.06.2014 cakton në fund të procedurës së përzgjedhjes së audituesit të jashtëm por nuk përfshihet në procesin e përzgjedhjes duke siguruar sipas bankës pavarësi të punës së komisionit të prokurimit.

Nisur nga aksesit i kufizuar që kemi patur në misionet tona audituese, në këtë institucion rekomandojmë që edhe në zbatim të standardit ndërkombëtar të INTOSAI-t, ISSAI 10, në ligj të përcaktohet e drejta e Kontrollit të Lartë të Shtetit për të patur akses të plotë mbi të gjithë dokumentacionin ekonomik-financiar, në funksion të vlerësimit sa më objektiv dhe të pavarur të përgjegjëshmërisë në administrimin e fondeve në dispozicion.

- Në ligj duhet të shprehet domosdoshmëria e bashkëveprimit institucional të këtyre subjekteve të kontrollit (Auditimi i Brendshëm, i Jashtëm dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit) në funksion të ofrimit të një sigurie maksimale në kushtet e shfaqjes së risqeve të ndryshme të lidhura sidomos me veprimtarinë investuese dhe operacionale të Bankës si dhe për të rritur besueshmërinë në vërtetimin e gjendjes financiare të Bankës Qendrore, interpretimin e saktë të pasqyrave financiare për të nxjerrë në dritë dallimet në mes objektivave lidhur me stabilitetin monetar dhe financiar dhe rezultatit të Bankës.

Në përgjigjen e Bankës shprehet qëndrimi se ky rekomandim duhet të adresohet Kuvendit të Shqipërisë, gjithashtu ka cilësuar që misionet e KLSH nuk kanë patur akses të kufizuar në dokumentacion, por dhënia e këtij dokumentacioni është bërë në përputhje me aktet rregullative në fuqi të Bankës së Shqipërisë, të cilat parashikojnë dhe procedura të vecanta për njohjen, dhënie administrimin, përdorimin e informacionit.

Është konstatuar se në zërin “Ndërtesë” mungon një klasifikim i kujdesshëm dhe i kodifikuar për të pasqyruar me saktësi koston historike të ndërtesës qendrore dhe atyre në dispozicion të degëve në rrethe. Kjo mungesë ka sjellë vështirësi në ndarjen e koston historike (apo dhe vlerën e rivlerësuar të tyre) nga koston e rikonstruksionit të bëra për këto objekte përgjatë viteve. Amortizimi i llogaritur për këtë zë na rezultoi me pasaktësi që sipas llogaritjeve tona për vitin 2013 ishin në vlerën 40,9 milionë lekë dhe 982 mijë lekë, ndërsa si amortizim i akumuluar kishte pasaktësi në vlerën 72 milionë lekë. Për këtë është rekomanduar

- Nga Departamenti i Kontabilitetit, Financës dhe Sistemit të Pagesave të bëhet saktësimi i vlerave sipas objekteve në pronësi të bankës saktësim që do të sjellë edhe korrigjimin e vlerës

së amortizimit për këto objekte. Departamenti i Kontrollit të kontrollojë realizimin e kësaj procedure.

Në përgjigjen e Bankës theksohet se rekomandimi është marrë në konsideratë dhe vazhdon puna për zbatimin e tij

Në zërin “Pajisje të përgjithshme”, kemi konstatuar se aty përfshihet vlera e të gjitha pajisjeve dhe inventarit ekonomik bashkë me objektet e inventarit të cilat janë plotësisht të amortizuara dhe për të cilat nuk ka siguri nëse janë të gjitha në përdorim apo jo. Gjatë këtij auditimi nuk e patëm të mundur krahasimin e vlerës së inventarizimit fizik dhe asaj të pasqyruar në kontabilitet, për shkak se ky dokumentacion nuk na u vu në dispozicion megjithë kërkesën e përsëritur të grupit të auditimit. Pajisjet të cilat janë nxjerrë jashtë përdorimit por nuk është marrë vendimi për asgjësimin e tyre nuk paraqiten në një llogari të veçantë që të evidentohen kontabilisht nga pajisjet të cilat janë në përdorim. U konstatua një përsheptim i amortizimit të këtyre pajisjeve në vlerën 21,7 milionë lekë. Banka e Shqipërisë është e pavarur dhe ka rregullimet e brendshme të saj por gjykojmë se baza rregullative e saj nuk mund të tejkalojë kërkesat ligjore aq më tepër ato që kanë të bëjnë me legjislacionin tatimor. Për këtë kemi rekomanduar

- (a) Të realizohet inventarizimi fizik i inventarit ekonomik dhe pajisjeve për çdo vit, sidomos në zërat që kanë ndikim të madh në vlerën e këtij zëri. (b) Të saktësohet evidenca kontabël e këtyre pajisjeve dhe të qartësohen politikat e amortizimit për pajisjet informatike. (c) Të bëhet rimarrje vlera prej 1,1 milionë lekë për amortizimin e gabuar (pikturave) të konstatuara gjatë këtij auditimi.

Në përgjigjen e Bankës theksohet se është ngritur grupi i punës për zbatimin e rekomandimeve (a) dhe (b), ndërsa rekomandimi (c) është zbatuar duke bërë sistemimin e vlerës 1,1 milionë lekë.

Për zërin Aktive të Qëndrueshme të Patrupëzuara u konstatuan pasaktësi lidhur me llogaritjen e amortizimit të zërave në përbërje të tij. Pasaktësi të lidhura me vlerësimin e jetëgjatësisë së elementëve në përbërje të zërit softëare dhe programe dhe pasaktësi të lidhura me momentin e fillimit të llogaritjes së amortizimit. Pasaktësi të cilat i kemi llogaritur në nivelin 17,9 milionë lekë. Për këtë kemi rekomanduar

- Të realizohet inventarizimi fizik i aktiveve në përbërje të zërit Aktive të Qëndrueshme të Patrupëzuara. Të saktësohet evidenca kontabël dhe të rishikohet me kujdes dhe të saktësohet politika e amortizimit të këtyre zërave dhe të bëhen saktësimet lidhur me konstatimet e grupit të auditimit.

Në përgjigjen e Bankës theksohet se rekomandimi është realizuar pjesërisht dhe brenda vitit 2015 realizohet plotësisht, me përfundimin e përmirësimit të sistemit informatik.

Nga audituesi i jashtëm për vitin 2012, është konfirmuar niveli i kuotizacioneve nga IBRD, MIGA, EBRD, IDA, IFC dhe IDB shuma prej 1,494 milionë lekë nga e cila 545 milionë lekë (janë paguar nga Banka e Shqipërisë dhe përfshirë në pasqyrën e pozicionit financiar si pjesë e aktiveve të tjera (në monedhë të huaj). Diferenca prej 942 milionë lekë paguar nga Republika e Shqipërisë dhe 7 milionë lekë për kuotizacione në Agjencinë e Garantimit të

Investimeve Shumëpalëshe që mbështeten nga Nota Premtuese, nuk janë përfshirë në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës. Lidhur me konstatimin se nuk ka një pasqyrim të saktë të kontributit original apo pronësinë së kuotizimeve pranë institucioneve financiare u konstatuan përpjekje drejt një Marrëveshje Kuadër me Ministrinë e Financave por gjithsesi, për shkak të kohëzgjatjes së kësaj problematike kemi rekomanduar:

- Nga ana e Bankës të ngrihet një grup pune që të saktësojë nga pikëpamja kontabël çdo pagesë dhe urdhëruesin e tyre për të bërë dhe ndarjen pronësore të asaj që ka ndodhur. Të përcaktohet trajtim kontabël i veçantë për kuotat e vjetra dhe atyre që do të paguhen në të ardhmen.

Në përgjigjen e Bankës theksohet se do bëhet riveifikimin e gjithë dokumentacionit të përdorur për të saktësuar veprimet kontabile të rekomanduara nga KLSH.

Lidhur me konstatimin se ka mungesa të dokumentacionit të lidhur me provigjionin në vlerë 129 milionë lekë, rast për të cilin grupi i auditimit gjykon se do të ishte më e përshtatshme që detyrimi të njëjti si pasiv i kushtëzuar, kemi rekomanduar:

- Në të gjitha rastet e provigjionimeve sidomos për çështje të cilat nuk kanë të bëjnë me aktivitetin operativ të Bankës, të zbatohet me përpikmëri baza rregullative në drejtim të plotësimit të gjykimit juridik dhe plotësisë së dosjes mbi të cilën provigjionohet një ngjarje me impakt të vlerësueshëm në rezultatin financiar të periudhave të ardhshme.

Në përgjigje e Bankës nuk shprehet për këtë rekomandim por në ballafaqimin e bërë pranë KLSH kemi arritur në një pikë takimi lidhur me trajtimin e këtij provigjioni.

Nga auditimi i Detyrimit për Fondin e Pensioneve kemi konstatuar se rezervat e tepërta në vite janë përdorur për të ristrukturuar kontributet e BSH në periudha të mëvonshme dhe jo në periudhën kur ato janë konstatuar. Sipas bilancit të Bankës së Shqipërisë në fund të vitit 2013 evidentohen 6,7 milionë lekë rezervë, e shprehur si “Paradhënie nga kontributet e bankës” për të cilën gjykojmë se duhet të trajtohet si rimarrje në pasqyrën e rezultatit financiar të vitit 2013. Për këtë kemi rekomanduar:

- Të bëhet rimarrje, për rezervat e pozicionuara në llogarinë “Paradhënie nga kontributet e bankës”. Të hartohet bilanc i plotë në momentin e ndarjes së këtij fondi nga bilanci i Bankës, me kartela sintetike dhe analitike dhe të zbatohen standardet ndërkombëtare të raportimit financiar në paraqitjen dhe dhënien e shënimeve shpjeguese për këtë lloj aktiviteti. Departamenti i Kontrollit të kontrollojë saktësinë e veçimit kontabël dhe vlerësimet që shoqërojnë këtë proces.

Në përgjigje e Bankës për këtë rekomandim theksohet se është bërë rimarrje për llogarinë “Paradhënie nga kontributet e bankës”, bilanci në momentin e ndarjes është zbatuar duke filluar nga muaji prill 2014 dhe sipas kësaj shkrese departamenti i kontrollit ka kontrolluar saktësinë e këtij vecimi, pra kjo pikë e rekomandimit quhet e zbatuar.

Nga auditimi i prokurimeve për ndërtime, mallra dhe shërbime të ndryshme rezultoi se janë zhvilluar gjithsej 110 procedura prokurimi, me fond limit 1,895 milionë lekë dhe janë lidhur 110 kontrata me vlerë 1,792 milionë lekë me një diferencë nga fondi limit prej 102 milionë

lekë. Prokurimet të realizuara me procedure tender i hapur janë 20 ose vetëm 18 % e numrit të tenderave, tendera me procedurë prokurimi të drejtpërdrejtë janë 48 prokurime ose 43,6% e numrit total të tenderave. Janë realizuar 42 procedura tender të kufizuar dhe kërkesë për kuotim ose 38,2% e numrit të tenderave por edhe në këtë rast ftesat për pjesëmarrje në këto procedura u janë drejtuar një numri të kufizuar nga 3 deri 5 operatorë ekonomikë duke nënkuptuar konkurrence të kufizuar. Konstatohet se, fondet e realizuara me prokurim të drejtpërdrejtë (si vlerë) përbëjnë 52,4 % të vlerës së prokuruar për këtë vit. Për të pasur rritje efektiviteti në drejtim të përdorimit të fondeve, kemi rekomanduar:

- Banka e Shqipërisë në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik të orientohet drejt zhvillimit të procedurave të prokurimit elektronik, për të siguruar një numër më të madh ofertuesish dhe për të rritur konkurrencën me qëllim uljen e kostove të të gjitha shërbimeve që kryhen për realizimin e objektivave të Bankës së Shqipërisë.

Nga Banka ky rekomandim merret në konsideratë, por theksohet pamundësia e realizimit brenda vitit 2014, në afatin e përcaktuar nga KLSH.

Nga auditimi i procedurave të tenderimit të realizuara nga Banka kemi konstatuar se përgjithësisht në të gjitha procedurat e tenderimit (përfshirë vetëm procedurën Tender i Hapur Kombëtar), minimizohen kërkesat e nevojshme dhe të domosdoshme për kualifikim të kandidatëve (individë, personit fizik ose personit juridik) të ftuar për të marrë pjesë në prokurim ose që kërkohen të ftohen, duke u mjaftuar vetëm me regjistrimin pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, praktikë kjo në kundërshtim me Rregullorën “Për Procedurat e Prokurimit të Bankës së Shqipërisë”, nenin 14 (Dokumentat e tenderit) pikën (d) ku specifikohen dokumentet që duhen të paraqiten nga kandidati për të demonstruar kualifikimet e tij, por në përputhje me kërkesat e Urdhrit nr.9287, datë 19.11.2009 “Për miratimin e dokumenteve standarde të prokurimit”. Pra konstatohet një hapësirë që sjell minimizim të kërkesave për kualifikim për kandidatët vendas ose të huaj. Për këtë kemi rekomanduar:

- Përmirësimin e bazës rregullatore që të mos ketë hapësira apo kapërcime ligjore në funksion të realizimit të një procedurë tenderimi duke synuar përputhshmëri të plotë me parimet e shprehura në nenin 2 të Rregullores për “Procedurat e Prokurimit në Bankën e Shqipërisë” por edhe të bazës tjetër rregullatore të veprimtarisë në Bankës dhe duke forcuar kërkesat dokumentare që vërtetojnë rregullshmërinë ligjore të kandidatëve dhe garantimin e cilësisë së produkteve të furnizuara dhe efikasitetin të plotë të shërbimeve të ofruara.

Nga Banka ky rekomandim merret në konsideratë, por theksohet fakti se do të zbatohet nga Komisioni i Prokurimit sa herë të jetë e mundur në vartësi të natyrës së prokurimit.

Auditimi i procedurave të prokurimit të furnizimit me karburant ka treguar se testimi i tregut (për furnizimin me karburant) në mbështetje të rekomandimit nr.170, datë 16.02.2012 “Lidhur me zbatimin e rregullave të zhvillimit të studimit të tregut për përcaktimin e fondit limit në procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë”, i është referuar vetëm operatorëve ekonomik (shqiptarë) pa marrë informacion të publikueshëm për çmimet e tregut të karburanteve kjo ka shkaktuar që çmimet e naftës dhe të benzinit të mos jenë afër realitetit të perceptuar çdo ditë. Gjithashtu u konstatua se në lidhje me përcaktimin e kërkesave specifike si dhe për vlerësimin e aftësive teknike e profesionale, të subjektit kandidat, kërkesat ishin

minimale, duke mos dhënë mundësinë e një sigurie optimale për shërbimin e ofruar në cilësinë e karburantit, në vazhdimësinë e kontratave një vjeçare. Për sa më sipër kemi rekomanduar:

- Shtimin dhe përmirësimin e kërkesave specifike që do të mundësojnë vlerësimin e aftësive teknike e profesionale, të subjektit kandidat, për të pasur një siguri optimale për shërbimin e ofruar në cilësinë e karburantit si dhe garantimin e vazhdimësisë së realizimit të kontratave një vjeçare.

Banka nuk është shprehur për këtë rekomandim pasi është shprehur për numër rekomandimi por çështja i referohet jo procedurave të prokurimit të karburantit por prokurimit të bilatave të avionit për të cilat është konstatuar se blihen me procedurë të drejtpërdrejtë dhe jo me procedura prokurimi.

Në rastin e kualifikimit të kandidatëve të ftuar nga jashtë në dokumentet kualifikuese të dorëzuar është vërejtur mungesa e vulës apostile, një mungesë e tillë e konsideruar një formalitet do të rriste besueshmërinë dhe saktëson rregullshmërinë e dokumentacionit në përputhje më bazën ligjore më të cilën operohet në territorin shqiptar dhe shtetit Italian. Këto konstatime rezultuan gjatë auditimit të objekteve “Realizimi i projektit për mobilimin e godinës së Bankës së Shqipërisë në sheshin “Skënderbej” me procedurë “Tender i kufizuar ndërkombëtar”, “Hartimi dhe zbatimi i projektit të Muzeut të Bankës së Shqipërisë” me procedurë “Procedurë e veçantë, sipas Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr.49, datë 25.07.2012”, “Shërbime shtesë projektimi, për ripunimin e projektit teknik të rikonstruksionit të ndërtesës së ish-hotel Dajti” me procedurë “Prokurim i drejtpërdrejtë me Ark...”, “Hartimi i projektit të zhvillimit të ambientit dhe trotuarit përreth ndërtesës së Bankës së Shqipërisë” prokurim i drejtpërdrejtë. Për këtë kemi rekomanduar:

- Dokumentat kualifikues për kandidatë të huaj, të jenë të noterizuara sipas rregullave të qarkullimit të dokumentacionit ndërmjet shteteve si dhe të shoqërohen me dokumentacion administrative shoqëruar të shtetit të huaj përkatës, për ta bërë procedurën tenderuese më të besueshëm, në përputhje më bazën ligjore më të cilën operohet në territorin shqiptar dhe të shtetit të huaj nga vjen kandidati.

Banka është shprehur se rekomandimi është marrë në konsideratë.

Në procedurat e tenderimit në fushën e ndërtimit, u konstatuan mungesa të preventivave të paraqitura në dosjen e prokurimit, analizat e zërave e punimeve të çmimeve dhe analizat teknike të tyre, konstatime të lidhura me dosjet e objekteve “Hartimi i projektit të zhvillimit të ambientit dhe trotuarit përreth ndërtesës së Bankës së Shqipërisë” si dhe “Mirëmbajtje dhe riparime të ndryshme në ndërtesat e Bankës së Shqipërisë në Tiranë, për një periudhë një vjeçare”. Për këtë kemi rekomanduar:

- Plotësimin e dosjeve të prokurimit me të gjitha studimet, projektet, preventivat e objekteve në ndërtim si dhe të kërkohet që vlera e objektit të llogaritet në zbatim të VKM-ve mbi “Manualat teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” sipas viteve përkatëse, pasi kjo shpreh saktë argumentimin e përllogaritjen e vlerës së investimit.

Banka është shprehur se rekomandimi është zbatuar.

a. Në auditimin e procedurës tenderuese me objekt i prokurimit “Shërbime shtesë projektimi, për ripunimin e projektit teknik të rikonstruksionit të ndërtesës së ish-hotel Dajti” me procedurë “Prokurim i drejtpërdrejtë me Ark...”, vihet re se nga ana e Bankës së Shqipërisë nuk është bërë një vlerësim i plotë nga ana strukturore, e objektit të ish- Hotel Dajti. Një analizë e plotë kur dihej që kjo godinë është ndërtuar në vitin 1942 dhe normalisht mbart amortizimin e kohës mund të kishte evidentuar problematikat e konstatuara në shtator të vitit 2012 gjithashtu mendojmë se një përjasje e kujdesshme nga ana e Bankës për këtë rast do të kishte parandaluar pagesën pjesore të këtij projekti me vlerën 184,800 Euro sipas kontratës bazë, duke evituar procedurën tenderuese për shtesën e vlerës së projektit të ish hotel Dajti, për ribërjen nga epara pikërisht të projektit për rikonstruksionin e godinës së ish-hotel Dajti.

b. Nga auditimi i ushtruar në dokumentacionin teknik, për ecurinë e realizimit të kontratave të lidhura për objektin “Hartimi i projekti dhe preventivit të zbatimit për rikonstruksionin e ndërtesës së ish Hotel Dajtit” dhe “Shërbime shtesë projektimi, për ripunimin e projektit teknik të rikonstruksionit të ndërtesës së ish-Hotel Dajti” u konstatua se janë realizuar dy studime gjeoteknike, me procedurë prokurimi “Blerje të vogla” në vitin 2011 dhe 2013, përkatësisht 17 dhe 8 blerje të vogla. Ndarja e studimit gjeologjik (të realizuar në vitin 2011) në këtë mënyrë duke mos qenë i shoqëruar me specifikime të qarta teknike, ka sjellë si pasojë realizimin e një studimi shtesë në vitin 2013 me vlerë 2,2 milionë lekë. Theksojmë faktin që rekomandimet e dhëna nga auditimi i vitit 2013 mbi këtë problematikë nuk ka gjetur zbatim.

c. Nga auditimi i kryer për zërat e shpenzimeve të prishjes të pasqyruara në situacionin progresiv likuiduar në datën 12.04.2013, u konstatua se, Autoriteti Kontraktor (Banka e Shqipërisë) nuk ka marrë masa për evidentimin e sasisë së metaleve të çmontuara, me qëllim shitjen në ankand apo lidhjen e një aktmarrëveshje me shoqërinë sipërmarrëse për t'i konvertuar materiale në formë skrapu në vlerën prej 2,090,400 lekë, dhe zbritjen e tyre për diferencë në situacionin progresiv. Për këtë kemi rekomanduar:

- Të analizohet edhe njëherë situata nga niveli drejtues dhe të merren të gjitha masat e mundshme për të rikuperuar kohen e tejkaluar në këtë projekt, kohë që përkt hehet në kosto qiraje për rezultatin e Bankës por edhe të shikohet mundësia që kostoja shtesë në gjykimin tonë jo plotësisht e arsyetuar të rikuperohet duke mos tejkaluar nivelin e parë të vlerës së planifikuar për të realizuar këtë rikonstruksion.

- Duhet të vlerësohet kostoja oportune e pagesave të qirasë të cilat vazhdojnë të paguhen nga Banka e Shqipërisë, ndërkohë që për kohën e shtyrjes së kontratave kjo kosto duhet t'i ngarkohet sipërmarrësit që nuk ka realizuar në kohë projektin ose në se janë fajtorë persona brenda BSH-së të përcaktohen këto përgjegjësi që efekti të mos rëndojë në rezultatin e Bankës (rekomandim i përsëritur nga viti i kaluar).

- Për rastet e justifikuara të hartohet dokumentacioni përkatës dhe të miratohen afatet për periudhat në vazhdim, duke vënë para përgjegjësisë palët kontraktore për realizimin plotësisht të kontratave të lidhura në cilësinë e kërkuar dhe kohën e përcaktuar (rekomandim i përsëritur nga viti i kaluar).

- Nga drejtimi të analizohet dhe të nxirren për gjegjësitë ndaj personave të cilët kanë lejuar me veprimet apo mos veprimet e tyre që të rriteshin kostot e objektit në mënyrë jo plotësisht të justifikuar për vlerën 2,2 milionë lekë.

Banka është shprehur se rekomandimi merret në konsideratë, po analizohet me përparësi dhe me përfundimin e tyre do informohet përsëri KLSH.

a. Nga auditimi i procedurës tenderuese me objekt “Hartimi i projektit të zhvillimit të ambientit dhe trotuarit përreth ndërtesës së Bankës së Shqipërisë” rezulton se në mënyrën e përlogaritjes së fondit limit të projektimit janë përdorur dy për qindje të ndryshme për koston e projektimit nga i njëjti subjekt projektues, i përzgjedhur për të dyja rastet nga Banka e Shqipërisë. Po në këtë objekt konstatoam se mënyra e llogaritjes së vlerës së investimit për trotuaret ndryshon nga preventivi paraprak i llogaritur me çmimin njësi prej 200 euro/m² (sipas relacionit të administruar në dosjen e tenderit), duke rritur në mënyrë të pajustificuar koston e projektimit me 2,884,000 lekë.

b. Nga auditimi i ushtruar në dokumentacionin teknik mbi ecurinë e realizimit të kontratave të lidhura për objektin “Rikonstruksioni i Godinës Qendrore dhe ndërtimi i Kompleksit të Ri të Bankës së Shqipërisë” dhe për objektin e tenderimit “Hartimi i projektit të zhvillimit të ambientit dhe trotuarit përreth ndërtesës së Bankës së Shqipërisë” u konstatua se shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve duhet të ishte bërë për 151 ditë dhe jo për 317 ditë. Shtyrja e pajustificuar e afatit të përfundimit të punimeve me 166 ditë më shumë, rëndon buxhetin e Bankës së Shqipërisë me pagesën e bërë nga kjo e fundit për ambientet e marra me qira, për 17,8 milionë lekë. Sipas informacionit të marrë nga Departamenti i Administrimit, për periudhën në vazhdim po shqyrtohet dokumentacioni i paraqitur nga sipërmarrësi për rishtyrjen e afatit të përfundimit të kontratës. Për sa kemi konstatuar kemi rekomanduar:

- Analizë e thelluar teknike për të gjitha tejkalimet e afateve, nxjerrja e përgjegjësisve konkrete midis sipërmarrësve dhe bankës, situatë që do të qartësonte se si mund të rikuperoheshin kostot shtesë të konstatuara. Në të gjitha rastet e vonesave të punimeve për shkak të sipërmarrësve të llogariten diferenca dhe të evidentohen mbi bazë dokumentare.

- Për të gjitha kontratat e punimeve të përcaktohen saktë arsyet që e detyrojnë BSH si Autoritet Kontraktor, të miratojë shtesën e afatit të përfundimit të punimeve, arsye që duhet të jenë të argumentuar shumë qartë nga pikëpamja teknike. Ndikimi i ditëve me mot të keq në shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve, të jetë i përcaktuar saktë. Për rastet e justifikuar të hartojë dokumentacionin përkatës dhe të miratojë afatet për periudhat në vazhdim, duke patur parasysh realizimin e kontratave në cilësinë e kërkuar dhe duke synuar rikuperimin e afateve të tejkaluara.

- Nga drejtimi të analizohet përgjegjësitë dhe të merren masat për të siguruar kthimin në buxhetin e bankës të kostove shtesë dhe penalteteve të llogaritura për mos përmbushje të detyrimeve kontraktore në afat.

Banka është shprehur se rekomandimi merret në konsideratë, po analizohet me përparësi dhe me përfundimin do informohet përsëri KLSH.

a. Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës me objekt “Ndërtimi i godinës së re të Departamentit të Emisionit të Bankës së Shqipërisë (BSH)” u konstatua se janë lidhur tre kontrata punimesh shtesë për këtë objekt, duke i konsideruar si kontrata të veçanta. Shqyrtimi i dokumentacionit teknik lidhur me argumentimin për nevojën e këtyre kontratave, na krijon bindjen që janë kontrata shtesë, në këtë kontekst gjykojmë se të paktën duhet të ishin ruajtur çmimet e kontratës bazë, në këtë mënyrë do të ishin kursyer kostot. Gjithashtu kemi arritur në përfundimin se miratimi prej 174 ditësh shtesë nuk është i justifikuar teknikisht. Deri në momentin e auditimit nuk rezulton të jenë llogaritur penalitete në zbatim të nenit 6 të Kontratës “Vonesat në shërbim”. Nga llogaritjet e bëra nga grupi i auditimit rezulton se për shkak të vonesave të sipërmarrësit duhet të ishte penalizuar në shumën 23,5 milionë lekë shumë që do të kishte ulur koston e realizimit të këtij objekti. Nga auditimi punimeve për këtë objekt u konstatuan diferenca për punime të pakryera në vlerën prej 4,7 milionë lekë. Për këtë kemi rekomanduar që:

- Kontratat e lidhura për punime në të njëjtin objekt, si të lidhura teknikisht dhe ekonomikisht me njëra tjetrën, duhet të konsiderohen si “Kontrata shtesë” dhe të trajtohen si të tilla edhe përsa i përket çmimëve.

- Analizë e thelluar teknike për të gjitha tejkalimet e afateve, nxjerrja e përgjegjësiive konkrete midis sipërmarrësve dhe bankës, situatë që do të qartësonte se si mund të rikuperoreshin kostot shtesë të konstatuara. Në të gjitha rastet e vonesave të punimeve për shkak të sipërmarrësve të llogariten diferenca dhe të evidentohen mbi bazë dokumentare.

Banka është shprehur se rekomandimi merret në konsideratë, po analizohet me përparësi dhe me përfundimin do informohet përsëri KLSH.

Nga auditimi i shpenzimeve, u konstatua se, për vitin 2013, janë blerë bileta udhëtimi me avion për jashtë shtetit në vlerën totale prej 28 milionë lekë. Për kryerjen e këtij shërbimi Banka e Shqipërisë ka kontaktuar drejtpërdrejtë me shoqërinë “ ” pa kryer më parë procedurë prokurimi në kundërshtim me Vendimin nr. 81, datë 15.11.2006 të Këshillit Mbikëqyrës “Për procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë” neni 7, “Kufijtë monetarë për përdorimin e “Tenderit të hapur” pasi, për periudhën e audituar ky shpenzim është më i lartë se 3 milionë lekë. Në të gjitha pagesat u konstatua se, në dokumentacionin justifikues bashkëlidhur urdhër shpenzimit, nuk u gjend dokumenti i lëshuar nga agjencia me emërtimin “Kodi i Rezervimit” (bileta elektronike) ku përcaktohet “Kosto faktike e udhëtimit” dhe komisioni për shërbimin që përfiton agjencia e udhëtimit, duke lënë shteg për rritje artificiale të kostonë së udhëtimit dhe të shpenzimeve të bankës, për këtë kemi rekomanduar:

- Departamenti i Administrimit të marrë masa për kryerjen e këtij shërbimi më procedurë prokurimi konform nenit 7, “Kufijtë monetarë për përdorimin e “Tenderit të hapur”, të përcaktuar në Vendimin nr. 81, datë 15.11.2006 të Këshillit Mbikëqyrës “Për procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë”

Banka është shprehur se rekomandimi është duke u shqyrtuar, është ngritur grupi i punës por nuk ka gjetur akoma eksperiencë të ngjashme të institucioneve shtetërore që realizojnë prokurimin e biletave të udhëtimit me avion nëpërmjet procedurës “Tender i Hapur” dhe se kërkon asistencë nga KLSH për trajtimin e një rasti të tillë.

Për periudhën objekt auditimi është kryer shërbimi i transportit të punonjësve të Departamentit të Emisionit sipas kontratës së lidhur me shoqërinë “ ” në vlerën totale prej 1,990,900 lekë me destinacion “Sheshi Skënderbej-Qesarakë me distancë 8 Km me tarifën mesatare prej 151 lekë për 1 punonjës. Kjo kontratë rezulton me çmime tepër të larta, madje e llogaritur edhe me çmimin 2,5 herë më të lartë se çmimi i tregut do të rezultonte në vlerën prej 1,320,000 lekë, duke sjellë një kursim prej 680,000 lekë, fakt që tregon se, procedura e zhvillimit të tenderit nuk ka sjellë përdorim efektiv të fondeve publike. Gjithashtu u konstatuan raste të mos dokumentimit të plotë dhe të rregullt të shpenzimeve të realizuara gjatë periudhës. Për këtë kemi rekomanduar që nga ana e Bankës të merren masa për eliminimin e problematikave të tilla që tregojnë për mos efektivitet të aktivitetit operativ të saj në drejtimet e cituara.

Banka është shprehur se lidhur me këtë rekomandim, po analizohen problematikat dhe po merren masat e nevojshme për eliminimin e tyre.

Janë kryer pagesa në favor të subjekteve private në vlerën totale prej 276,762 lekë pa përcaktuar dhe argumentuar domosdoshmërinë e kryerjes së shërbimeve, duke sjellë si pasojë shpenzime jo efektive.

- Sa cilësuar më sipër nga ana e Bankës të merren masa për eliminimin e shpenzimeve të pastuduara dhe jo efektive gjatë aktivitetit të përditshëm të saj

Banka është shprehur se rekomandimi merret në konsideratë me qëllim përdorimin efektiv të fondeve publike.

Banka e Shqipërisë ka lidhur një marrëveshje bashkëpunimi me universitetin “ ”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 52, datë 31.07.2013 me vlerën totale prej 162,000 euro, me objekt “Për të analizuar sfidat makroekonomike dhe financiare me të cilat ato përballen, si dhe nxitja e thellimi i njohurive mbi vlerësimin e politikave të mundshme për nxitjen e rritjes së qëndrueshme ekonomike në rajon si dhe integrimin në bashkimin Evropian”. Pagesa pjesore në vlerën prej kryer me një faturë të printuar në model A4 datë 27.09.2013, dhe nuk kishte të bashkëngjitur një analizë të plotë të aktiviteteve të bëra nën këtë projekt. Për këtë kemi rekomanduar:

- Transparençën e plotë të materialit apo produktit sipas marrëveshjes së lidhur me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 60 datë 31.08.2010 dhe vendimit nr. 52, datë 31.07.2013, dhe plotësimin e dokumentacionit që shoqëron pagesat sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Për këtë rekomandim Banka e Shqipërisë paraqiti dokumentacionin justifikues, dhe si pasojë rekomandimi konsiderohet i zbatuar. Trajtimi i mëtejshëm i këtij rekomandimi ka të bëjë kryesisht me periudhat e ardhshme, me qëllim sigurimin e transparencës në çdo kontratë të lidhur me operatorë të huaj.

U konstatua se Banka e Shqipërisë ka lidhur kontratë me shoqërinë “ ” për marrje me qira të dy ambienteve, respektivisht Godina A dhe B. Këto ambiente, ndonëse janë pjesë të së njëjtës godinë në të njëjtin vend, dhe kanë të njëjtën cilësi punimi; tarifat për njësinë e sipërfaqes janë të ndryshme, duke sjellë si pasojë rritjen artificiale të shpenzimeve qysh në kontratën fillestare të lidhur në vitin 2009. Kontrata për godinën B është lidhur pa negociuar

me ofertuesin e përzgjedhur unifikimin e çmimit me tarifën më të ulët prej 1,750, lekë/m² të ofruar për Kullën A, për të mundësuar uljen e kostos së këtij shërbimi në vlerën prej 4,2 milionë lekë në çdo vit që kontrata përsëritet. Për këtë kemi rekomanduar:

- Për periudhën në vazhdim të marren masa dhe të negociohet për të kërkuar unifikimin e çmimit me tarifën më të ulët prej 1,750, lekë/m² me qëllim përfitimi të vlerës prej 4,213,941 lekë në vit.

Për këtë rekomandim Banka e Shqipërisë shprehet se e merr në konsideratë dhe ka kërkuar unifikimin e çmimit të qirasë së objektit nga operatori ekonomik.

Në referencë të gjithë gjetjeve të sipërcituara të këtij auditimi si dhe bazuar në adresimet e bëra në të, lidhur me aspekte të cilat kanë nevojë për ndërhyrje të menjëhershme por dhe të kujdesshme, i rekomandojmë Guvernatorit dhe Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të bëjnë një analizë të plotë dhe të thellë për të përcaktuar përgjegjësitë administrative dhe financiare dhe për të gjykuar në mënyrë sa më racionale mbi masat që duhet të ndërmerren në krijimin e një mjedisi të shëndetshëm në menaxhimin e burimeve në dispozicion të Bankës së Shqipërisë, në rritjen e llogaridhënies dhe një qasje koherente në drejtim të transparencës, që do të ndikonte në një balancë optimale ndërmjet pavarësisë dhe mirëqeverisjes.

Sikurse citojmë në Vendimin Nr. 108, datë 09.09.2014 për këtë Auditim, ky raport është përgatitur duke respektuar punën e kryer deri tani nga Banka e Shqipërisë për sigurimin e stabilitetit financiar të vendit, pavarësinë e saj kushtetuese, por edhe në kushtet e qasjes së kufizuar në informacionin dhe dokumentacionin bankar.